



info

për të afërmit
e të paraburg-
osurve

ÇFARË DO TË THOTË PARABURGIMI DHE PSE NUK MARR INFORMACIONE?

Paraburgimi mund të urdhërohet kur një person dyshohet me bazë të fortë për një vepër penale dhe ekziston rreziku që të arratiset, të zhdukë prova, të kryejë vepra të tjera penale ose të kryejë një kërcënim penal.

Prokuroria nuk nuk ka të drejtë t'u japë familjarëve asnjë informacion për procedurën. Informim e marrin vetëm personi i ndaluar dhe avokati/avokati i tij. Avokati/ja mund të përcjellë informacione të caktuara nëse personi i arrestuar e lejon këtë.

Çfarë më ndihmon në këtë kohë të vështirë?

- **Qëndroni të qetë:** Shumë njerëz ndiejnë frikë, zemërim ose trishtim – kjo është krejtësisht normale.
- **Mbani rutinat e përditshme:** Kjo ju ndihmon të gjeni stabilitet në jetën e përditshme gjatë kohërave të trazura.
- **Të folurit ndihmon:** Bisedoni me një person të besueshëm, kontaktoni qendrat tona të këshillimit ose bashkohuni në grupin tonë për familjarët. Heshtja shpesh e bën më të vështirë.

Çfarë t'i them fëmijës tim?

Fëmija juaj e ndjen që diçka nuk shkon. Mundohuni të gjeni një shpjegim të sigurtë dhe të kujdesshëm për fëmijën tuaj. Mendoni për këtë: Çfarë kupton tashmë fëmija im? Cilat informacione janë shumë të rënda për të? Jepini atij ndjenjën e sigurisë dhe ruani sa më shumë rutinën e përditshme.



Ndjem i/e pafuqishëm/me – çfarë mund të bëj?

Është normale të ndihesh i/e pafuqishëm/me kur një person i afërt arrestohet. Ju dëshironi të ndihmoni, por nuk mund të ndërhyri ose të keni kontakt të drejtpërdrejtë. Megjithatë, ka gjëra që mund të bëni:

- **Shkruani letra:** Ato kanë shumë rëndësi për të burgosurin. Mund të dërgoni edhe foto ose vizatime
- **Dorëzimi/transferimi i parave:** Personi i ndaluar mund t'i përdorë për të blerë në kioskën e burgut.
- **Merrni përsipër punët administrative:** Me autorizim mund të kujdeseni për gjëra të rëndësishme të personit të arrestuar, si faturat apo posta.
- **Aplikoni për një leje vizite:** Për vizita në paraburgim keni nevojë për leje nga prokuroria. Paraqisni një aplikim për këtë.

Detalet i gjeni në faqet e mëposhtme.

MUNDËSITË E KONTAKTIT NË PARABURGIM

A lejohen personat e arrestuar të bëjnë telefonata?

Jo. Në paraburgim telefonatat nuk lejohen.

Shkrimi i letrave

- Ju mund t'i shkruani letra personit të arrestuar.
- Lejohen foto dhe vizatime të fëmijëve, por jo ngjitëse apo stikers.
- Nuk lejohen diskutime për procesin penal.
- Të gjitha letrat lexohen nga prokuroria.
- Letra duhet të dërgohet te prokurori/prokurorja përgjegjës(e) ose te burgu (adresën e gjeni në faqen e internetit të burgut).

E rëndësishme: Shkruani emrin e plotë e personit të arrestuarit dhe shkruani adresën tuaj në pjesën e pasme të zarfit. Kështu i ka personi i arrestuar të dhënat tuaja të kontaktit.

Pako me postë

Paketat mund të dërgohen në burg.

Nuk ka kufi në muaj.

Lejohen: Vetëm rroba dhe cigare, maksimumi 5 kg

E rëndësishme: Shkruani emrin e plotë të personit të arrestuar në adresë dhe shkruani adresën tuaj në paketë.

Gjërat që mund të sillni gjatë vizitës:

Lejohen: Rroba (maksimum një çantë pazari), veshje të rehatshme dhe të brendshme, cigare, para cash, artikuj higjienike, lista e barnave/medikamenteve që i duhen personit të arrestuar – I burgosuri mund t'ia dorëzojë listen shërbimit mjekësor të burgut

Nuk lejohen: Gjëra prej lëkure (rrypa, doreza, rroba etj. prej lëkure), barna/medikamente (sigurohen nga shërbimi mjekësor i burgut).

E rëndësishme: Nuk mund ti dorëzoni gjërat drejtpërdrejt të arrestuarit, por duhet t'i dorëzoni në repartin e pranimit.

Dorëzimi i ushqimit dhe pijeve në burg

Lejohet vetëm në muaj të caktuar:

1 deri më 28 shkurt	1 deri më 30 prill
1 deri më 30 qershor	1 deri më 31 gusht
1 deri më 31 tetor	1 deri më 31 dhjetor.

Rregulloret/informacionet specifike i gjeni në rregulloren e brendshme të burgut (vetëm në gjermanisht).

VIZITA NË BURG

Kush mund të vijë për të vizituar?

- Familja, të afërmit, miqtë, kolegët e punës që kanë leje vizite nga prokuroria
- Zakonisht lejohet 1 orë vizitë në javë për personin në paraburgim.
- Fëmijët lejohen të vizitojnë me një të rritur

Si të marr leje për vizitë dhe ku ta regjistroj vizitën?

Shkruani një e-mail prokurorisë përgjegjëse me përmbajtjen e mëposhtme:

- Emri juaj i plotë dhe marrëdhënia juaj me personin e arrestuar (bashkëngjitni kopje të ID-së tuaj)
- Emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes e personit të arrestuar
- I njëjti proces vlen edhe për fëmijët, ata gjithashtu kanë nevojë për leje.



Mund të duhen disa ditë që ju të merrni një përgjigje. Disa vizita monitorohen ose regjistrohen. Vizitat në paraburgim zakonisht bëhen me një xham ndarës.

Nëse keni një leje për vizitë, caktoni një takim me burgun përmes telefonit.

- Oraret e vizitës i gjeni në faqen e internetit të burgut.
- Në disa burgje, pasditja e së mërkurës është e rezervuar për vizita me fëmijë.

TEMA FINANCIARE

Paratë për një person në paraburgim – Si funksionon?

Ju mund ti dërgoni para një personi të arrestuar – në dy mënyra:

- **Dorëzimi i parave të gatshme/cash:**
Sillni paratë në burg gjatë orarit të hapjes/ të punës. Ju merrni një faturë.
- **Transferoni para:** Transferoni paratë dhe vendosni mbiemrin, emrin dhe datën e lindjes së personit të arrestuar. Përdorni të dhënat bankare të burgut. Këto mund t'i gjeni në faqen e internetit të burgut.

Shuma e parave: 50 deri në 200 franga për çdo dërgesë me bankë. Maksimumi 2000 franga në vit.

A kam të drejtë për mbështetje financiare?

Nëse për shkak të arrestimit të partnerit/ partneres suaj keni vështirësi financiare, kontaktoni shërbimet sociale të komunës tuaj. Aty do të kontrollohet nëse mund të merrni ndihmë sociale.

Ndihma afatshkurtër ofrohet nga kisha, organizata ndihmëse ose fondacione private. Në këtë rast mund të na kontaktoni direkt.

Kush paguan qiranë, faturat, sigurimin shëndetësor, alimentet e fëmijëve? të të burgosurit?

Këto shpenzime duhet të paguhen.

Një detyrë që mund të bëhet shpejt sfiduese dhe për të cilën keni nevojë për mbështetje profesionale. Na kontaktoni për këshilla.

Çfarë mund të bëj për personin e arrestuar dhe çfarë më duhet?

Me një prokurë (Vollmacht) ose prokurë të përgjithshme mund të menaxhoni çështjet administrative në emër të personit të arrestuar. Këshillë për çështjet bankare: Pyetni në bankë nëse kanë formularë të tyre për prokurë – përdorni ato.

Informacion për punëdhënësin/punëdhënësen

Punëdhënësi/punëdhënësjë informohet për arrestimin vetëm nëse personi i burgosur e dëshiron këtë. Shpeshherë, këtë detyrë e marrin përsipër avokatët. Por edhe anëtarët e familjes ose shërbimi social i burgut mund ta kryejnë këtë detyrë.



SHËRBITET BAZË/ BAZIKE NË BURG

Shërbimi social i burgjeve: Shërbimi social ndihmon personat e paraburgosur me pyetje në lidhje me strehimin/banimin, punën, financat ose familjen. E rëndësishme të dihet: Përdorimi i shërbimeve sociale është vullnetar në paraburgim. Personat e arrestuar duhet të kërkojnë vetë shërbimet sociale.

Kujdesi/shërbimi mjekësor: Personat e paraburgosur kanë të drejtë për kujdes shëndetësor me të njëjtën cilësi si qytetarët jashtë burgut.

Kujdesi shpirtëror në burg: Në burgjet e Kantonit të Cyrihut, të gjithë personat e burgosur kanë qasje në kujdes shpirtëror nga përfaqësues të feve të ndryshme.

Ushqimi: Personat e burgosur marrin tri herë në ditë ushqim.

Kioska e burgut: Personat e burgosur mund t'i përdorin paratë e tyre për të blerë ushqime, snacks, pije, artikuj higjienike, artikuj shkrimi dhe produkte për duhan

Higjiena personale: Ka dushe dhe, nëse është e nevojshme, ofrohen rroba të pastra. Robotat personale lejohen dhe janë të mirëpritura.

Sporti: Personat e burgosur mund të bëjnë sport në dhomën e fitnesit.

Televizioni: Një televizor mund të merret me qira.

Puna: Personat e paraburgosur nuk janë të detyruar të punojnë. Nëse burgu ofron punë, ata mund të punojnë dhe të fitojnë para shtesë

E DREJTA PËR MBROJTJE JURIDIKE



Një person i burgosur merr një avokat ose një avokate nëse qëndron në paraburgim për më shumë se dhjetë ditë pa ndërprerje; në rast të akuzave të rënda, kjo ndodh menjëherë pas arrestimit. Personi i burgosur mund të zgjedhë vetë një avokat ose një avokate. Nëse nuk njih askënd, shteti organizon një avokat ose një avokate për të.

Cili është dallimi ndryshimi midis mbrojtjes së detyrueshme dhe asaj zgjedhore?

- **Mbrojtja me zgjedhje/zgjedhore:** Personi i burgosur e zgjedh dhe e paguan vetë avokatin ose avokaten.
- **Mbrojtja e detyrueshme:** Shteti organizon avokatin/avokati dhe paguan shpenzimet, por mund t'i kërkojë paratë më vonë mbrapsht.

Avokatet dhe avokatët e mbrojtjes së detyrueshme janë po aq të mirë sa ata të mbrojtjes me zgjedhje. Të dy punojnë në mënyrë të pavarur nga shteti dhe vetëm në interes të personit të burgosur.

Keni ndonjë pyetje?
Ju duhen më shumë
informacione?
Ne jemi këtu për ju!



infoBUS
für Angehörige
von Inhaftierten

Sandra Baur
team72
076 301 40 32
baur@team72.ch



Ivana Mehr
ExtraMural
079 514 01 23
mehr@extramural.ch

